

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT TË REGJISTRIMIT PRANË IEKA**

Mbështetur në nenin 19, pika 4 si dhe në nenin 60, pika 5 e ligjit Nr.10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 874, datë 12.08.2009, me propozim të IEKA-s, Bordi i Mbikqyrjes Publike miraton këtë Rregullore:

Objekti i Rregullores dhe fusha e veprimit

Kjo Rregullore përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:

- 1. Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Regjistrimit;**
- 2. Procedurat e regjistrimit dhe të ç’regjistrimit nga regjistri publik i ekspertëve kontabël dhe të shoqërive audituese vendase dhe të huaja;**

Autoriteti i Regjistrimit

1. Krijimi dhe përbërja e tij.

Autoriteti i Regjistrimit është organi kolegjal i krijuar në përputhje me dispozitat e nenit 2, pika 5 të ligjit. Ai merret me zbatimin e procedurave të regjistrimit dhe të ç’regjistrimit nga regjistri publik të ekspertëve kontabël të regjistruar vendas dhe të huaj, dhe të shoqërive të auditimit, vendase dhe të huaja.

Autoriteti i Regjistrimit përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen për një periudhë trevjecare. Kryetari i Autoritetit të Regjistrimit emërohet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Katër anëtarët emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a) një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- b) një përfaqësues i Ministrisë që mbulon fushën e ekonomisë;
- c) një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
- d) një përfaqësues i organizatës profesionale të ekspertëve kontabël të regjistruar.

Anëtarët e Autoritetit të Regjistrimit duhet të jenë individë të diplomuar dhe të specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të lidhura me auditimin, kontabilitetin ose financën, me përvojë pune jo më të vogël se pëse vjet, si dhe të kenë punuar në institucionin apo organizatën propozuese. Të paktën njeri nga anëtarët e

Autoritetit të Regjistrimit, (kryetari ose përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë) duhet të jenë juristë.

2. Procedurat e punës së Autoritetit të Regjistrimit

Autoriteti i Regjistrimit mblidhet me thirrjen e Kryetarit, sa herë që është e nevojshme dhe jo më pak se një herë në dy muaj. Me kërkesë të Kryetarit kur ka çështje që kërkojnë vendimmarrje, Autoriteti i Regjistrimit mund të mblidhet edhe më shpesh. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet mund të thirren dhe të drejtohen nga anëtari i Autoritetit, përfaqësues i Ministrisë që mbulon fushën e ekonomisë.

Mbledhja njoftohet të paktën 5 ditë para datës së zhvillimit dhe njoftimi përmban datën, orën, rendin e ditës si dhe relacionin përkatës. Njoftimi i mbledhjes bëhet nga Instituti.

Kryetari i Autoritetit të Regjistrimit cakton njërin nga anëtarët e Autoritetit për të shqyrtuar materialet dhe përgatitur relacionin. Kryetari mund të caktojë dhe specialistë të fushave përkatëse, për përgatitjen e relacionit.

Mbledhjet e Autoritetit të Regjistrimit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave, (jo më pak se tre vota), dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Vendimet kundër duhet të jenë të argumentuara në proces-verbal. Vendimet depozitohen në selinë e Institutit. Çdo vendim i Autoritetit të regjistrimit i njoftohet të interesuarit nëpërmjet Institutit. Kopje e vendimit i dërgohet regjistrimit publik të ekspertëve kontabël.

Mbledhjet e Autoritetit të Regjistrimit dokumentohen me proces-verbal i cili firmoset nga kryetari (dhe një anëtar i komisionit, i cili nuk është anëtar i Institutit si) dhe nga sekretari i Autoritetit.

Vendimet për rrezimin e kërkesave për t'u regjistruar në listën e institutit duhet të jenë të motivuara.

Vendimet e Autoritetit të regjistrimit janë të apelueshme pranë Bordit të Mbikqyrjes Publike. Apelimet bëhen brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

Procedurat e regjistrimit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të shoqërive audituese

3. Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të ekspertëve kontabël të regjistruar.

Regjistrimi është procesi i përfshirjes së ekspertëve kontabël vendas dhe të huaj si dhe shoqërive të auditimit vendase dhe të huaja në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të regjistruar.

Procedurat dhe kushtet për regjistrim janë përcaktuar në nenet 20, 21 dhe 22 të Ligjit. Kanë të drejtë të regjistrohen në regjistrin publik të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj që plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas ligjit.

4. Dokumentat për regjistrim të personave fizikë.

Kërkesa e kandidatit për regjistrim që i adresohet Autoritetit të Regjistrimit duhet të depozitohet në Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

a) Për personat fizikë shtetas shqiptar.

Dokumentacioni i nevojshëm përmban sa më poshtë:

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar Autoritetit të Regjistrimit, nënshkruar prej tij;
2. Vërtetim për përfundimin me sukses të provimeve të aftësisë profesionale;
3. Curriculum vitae;
4. Dokument identiteti;
5. Formular vetëdeklarimi për gjendjen gjyqësore;
6. Vërtetim zyrtar nga institucioni, shoqëria etj. për ndërprerjen e marrëdhënieve të punësimit (kur personi ka qënë i punësuar);
7. Deklaratë noteriale për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;
8. Cdo dokument tjetër që mund të gjykohej i nevojshëm në funksion të përmbushjes së kushteve të regjistrimit.

b) Për personat fizikë shtetas të huaj

Për t'u regjistruar në regjistrin publik, eksperti kontabël i huaj i drejtohet, me një kërkesë me shkrim, Autoritetit të Regjistrimit e cila depozitohet në Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Dokumentacioni i nevojshëm përmban sa më poshtë:

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar Autoritetit të Regjistrimit, nënshkruar prej tij;
2. Kopje të licensës profesionale ose vërtetim të organizmit profesional ose autoritetit publik të shtetit të cilit i përket, të noterizuar dhe legalizuar nga autoriteti publik përkatës i shtetit të tij (Ministria e Jashtme, ajo e Drejtësisë etj.)
3. Vërtetim nga organizmi profesional që kandidati e ushtron profesionin e ekspertit kontabël të regjistruar dhe nuk ka papajtueshmëri.
4. Raport nga Këshilli Drejtues i IEKA-s për vlerësimin e përgatitjes së ekspertit kontabël të huaj me ekspertët kontabël të regjistruar vendas.

5. Vërtetim të lëshuar nga Autoriteti i Certifikimit për kryerjen dhe shpalljen fitues të testit të njohurive, sipas shkronjës (b) dhe (d) të pikës 2, të nenit 18 të ligjit.
6. Curriculum vitae;
7. Dokument identiteti;
8. Formular vetëdeklarimi për gjendjen gjyqësore;
9. Deklaratë noteriale për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;
10. Cdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm në funksion të përmbushjes së kushteve të regjistrimit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

c) për shtetasit shqiptarë që kanë fituar titullin CPA ose ACCA

Shtetasit shqiptarë që kanë fituar titullin CPA ose ACCA në një shtet tjetër, përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e provimit të aftësisë profesionale për shkronjat “a”, “c” dhe “ç” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit të cituar më sipër.

Për t’u regjistruar në regjistrin publik, Shtetasit shqiptarë që kanë fituar titullin CPA ose ACCA në një shtet tjetër, i drejtohen me një kërkesë me shkrim Autoritetit të Regjistrimit e cila duhet të depozitohet në Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Kërkesa shoqërohet me dokumentet e nevojshëm, që tregon për titullin e marrë në një shtet tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm përmban sa më poshtë:

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar Autoritetit të Regjistrimit, nënshkruar prej tij;
2. Kopje të licenses profesionale ose vërtetim të organizmit profesional ose autoritetit publik të shtetit të cilit i përket të noterizuar dhe legalizuar nga autoriteti publik përkatës i shtetit të tij (Ministria e Jashtme, ajo e Drejtësisë etj.);
3. Vërtetim për përfundimin me sukses të provimeve të aftësisë profesionale (sipas shkronjave “b” dhe “d” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit);
4. Vërtetim anëtarësimi nga organizmi profesional i shtetit të huaj në të cilin janë anëtarë.
5. Curriculum vitae;
6. Dokument identiteti;
7. Formular vetëdeklarimi për gjendjen gjyqësore ;
8. Vërtetim zyrtar nga institucioni, shoqëria etj. për ndërprerjen e marrëdhënieve të punësimit (kur personi ka qënë i punësuar);
9. Deklaratë noteriale për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;
10. Cdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm në funksion të përmbushjes së kushteve të regjistrimit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

5. Paraqitja, pranimi i kërkesës dhe dokumentave për regjistrim i shoqërive audituese vendase dhe të huaja.

Autoriteti i Regjistrimit regjistron një shoqëri audituese për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se shoqëria audituese plotëson kushtet e parashikuara në ligj.

Kërkesa për regjistrim të shoqërisë në regjistrin publik, bëhet nga administratori i shoqërise dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për shoqëritë vendase.

1. Vendimi i asamblesë së ortakëve/aksionerëve për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin publik të ekspertëve kontabël;
2. Certifikatën e regjistrimit në QKR;
3. Kopje të ekstraktit të QKR;
4. Statuti i shoqërisë;
5. Listën e ekspertëve të shoqërisë;
6. Të dhëna të tjera sipas nenit 29 të ligjit.
7. Cdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm në funksion të përmbushjes së kushteve të regjistrimit.

b) Për shoqëritë e huaja

1. Vendimi i asamblesë së ortakëve/aksionerëve për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin publik të ekspertëve kontabël;
2. Certifikatën e regjistrimit në QKR;
3. Kopje të ekstraktit të QKR;
4. Statuti i shoqërisë;
5. Listën e ekspertëve të shoqërisë/degës;
6. Një dokument që vërteton plotësimin e pikës (b) të nenit 21 të Ligjit;
7. Të dhëna të tjera sipas nenit 29 të ligjit.
8. Cdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm në funksion të përmbushjes së kushteve të regjistrimit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

6. Pezullimi i veprimtarisë së ekspertit kontabël të regjistruar

Eksperti kontabël i autorizuar, me një kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë, mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga ushtrimi i profesionit.

Kërkesa për pezullim i drejtohet me shkrim Autoritetit të Regjistrimit, përmes Institutit. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë veprimtarinë e re, që do të ndërmarrë i interesuari, si dhe periudhën për të cilën kërkohet pezullimi apo, kur kjo periudhë nuk mund të identifikohet, datën, në të cilën kërkohet të fillojë pezullimi.

Autoriteti i Regjistrimit e shqyrton kërkesën në mbledhjen e tij më të parë dhe, nëse çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, e miraton kërkesën dhe vendos fshirjen e përkohshme të të interesuarit nga regjistri publik i ekspertëve kontabël të regjistruar. Kopje e vendimit i dërgohet regjistrit publik të ekspertëve kontabël.

Eksperti kontabël i regjistruar ka të drejtë të nisë veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga Autoriteti i Regjistrimit, me kusht që të informojë për këtë, me shkrim, organizatën profesionale të ekspertëve kontabël, të paktën dhjetë ditë më parë, të ketë shlyer kuotat profesionale dhe të ketë pushuar veprimtarinë si ekspert kontabël. Në rastet kur eksperti kontabël ka nisur veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga Autoriteti i Regjistrimit dhe ky i fundit vëren, gjatë shqyrtimit, se veprimtaria e tij e re është e natyrës, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, vendos çregjistrimin e ekspertit kontabël nga regjistri publik i ekspertëve kontabël.

Nga data e njoftimit të vendimit, që shpall fshirjen e përkohshme nga regjistri publik, i interesuari nuk është më anëtar i organizatës profesionale. Ai nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e vet profesionin e ekspertit kontabël të regjistruar dhe as ta përdorë këtë titull.

Fshirja e përkohshme nga regjistri publik, me kërkesën e ekspertit kontabël, nuk ka efekt mbi procedurat disiplinore, të nisura për shkeljet e kryera prej tij përpara fshirjes.

7. Riregjistrimi në regjistrin publik të ekspertëve kontabël

Anëtari i tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit mund të kërkojë riregjistrimin e tij.

Riregjistrimi nga Autoriteti i Regjistrimit bëhet nëse eksperti kontabël ka përmbushur të gjitha detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional edhe gjatë kohës kur ai nuk e ka ushtruar profesionin.

Kërkesa e ekspertit kontabël për riregjistrim i adresohet Autoritetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të ekspertëve kontabël dhe shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

1. Curriculum vitae;
2. Formular vetëdeklarimi për gjendjen gjyqësore;
3. Vërtetim zyrtar nga institucioni, shoqëria etj. për ndërprerjen e marrëdhënieve të punësimit (nëse personi ka qënë i punësuar);
4. Deklaratë noteriale për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;

5. Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për pjesëmarrjen në kualifikimin e vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e e.k.r.
6. Cdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm, në funksion të përmbushjes së kushteve të regjistrimit, që mund të kërkohet nga Autoriteti i Regjistrimit.

8. Çregjistrimi i ekspertëve kontabël nga regjistri publik

Autoriteti i Regjistrimit në zbatim të nenit 26 të ligjit, merr në shqyrtim njoftimet e bëra nga organizata profesionale e ekspertëve kontabël të regjistruar

1. Eksperti kontabël fshihet përfundimisht nga regjistri publik i ekspertëve kontabël në rastet kur:

- a) heq dorë nga e drejta për ushtrimin e profesionit. Heqja dorë bëhet nëpërmjet deklarimit me shkrim, kopje të të cilit i dërgohen organizatës profesionale dhe bordit të mbikëqyrjes publike;
- b) konstatohen parregullsi në:
 - i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;
 - ii. deklaratimet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik;
 - iii. dokumentet e në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;
- c) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;
- d) është hequr e drejta e ushtrimit të profesionit, për shkak të ndryshimit të kushteve të domosdoshme për regjistrim, të lidhura me pjesëmarrjen në kapital;
- e) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;
- f) në përputhje me dispozitat e këtij ligji, bordi ka vendosur çregjistrimin nga regjistri publik;
- g) individi i regjistruar në regjistrin e ekspertëve kontabël arrin moshën 65 vjeç, me përjashtim të ekspertëve kontabël me titull shkencor “Doktor i shkencave” apo me titull më të lartë, të cilët çregjistrohen kur arrijnë moshën 68 vjeç;
- h) vdes.

2. Shoqëria audituese fshihet përfundimisht nga regjistri publik i ekspertëve kontabël në rastet kur:

- a) me kërkesën e saj të bërë nga administratori i shoqërisë;
- b) përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;
- c) e drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri auditimi hiqet nga bordi.

9. Kostot regjistrimit

Kostot e regjistrimit në regjistrin publik mbulohen nga aplikantët. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar përcakton tarifa të diferencuara bazuar në kostot e procedurave përkatëse.

10. Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi sot më datë 02.02.2010, pasi u miratua nga Bordi i Mbikqyrjes Publike me vendimin nr. 5 datë 22.12.2009 dhe Ministri përgjegjës për Ekonominë, me shkresen nr.1164 datë 02.02.2010